



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 16/09/2022, Ref.: 1323/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Udhëzimit Administrativ MASHT NR.08/2019 i datës 17.05.2019 për ndryshim dhe plotësimin e udhëzimit administrativ Nr.15/2018 dt 28.09.2018 për akreditimin e IAL-ve në Republikën e Kosovës dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 104-të, të mbajtur më 01.09.2022, mori:

#### V E N D I M

- I. **Validohet** akreditimi ndërkombëtar i programit të studimit të Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) për periudhën 1 tetor 2022 - 30 shtator 2025:
  1. *Studime Profesionale, MSc 66 ECTS, me specializim Parashikim Strategjik dhe Inovacion, me maksimum 30 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) që deri me datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ MASHT NR.08/2019 i datës 17.05.2019 për ndryshim dhe plotësimin e udhëzimit administrativ Nr.15/2018 dt 28.09.2018 për akreditimin e IAL-ve në Republikën e Kosovës dhe çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportoj dhe arsyetoj në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për validim të akreditimit të programit të studimit;

- *Studime Profesionale, MSc 66 ECTS, me specializim Parashikim Strategjik dhe Inovacion, me maksimum 30 studentë për vit akademik.*

Për programin e akredituar si në dispozitiv të këtij vendimi, KSHC ka aprovuar listën e bartësve si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Studime Profesionale, MSc 66 ECTS, me specializim;</i> (Strategic Foresight and Innovation), Validim	Albina Balidemaj Fadil Sahiti

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 104-të, të mbajtur më 01.09.2022 ka shqyrtuar kërkesën e RIT Kosovo (A.U.K.) College dhe në bazë të certifikatave dhe dëshmimeve të ofruara për akreditimin e këtij programi nga Middle State Commission on Higher Education/MSCHE, kompetencat dhe referencat ligjore të cekura më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- RIT Kosovo (A.U.K.);
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

